



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Afrim Shala, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve B. N. dhe A. N., për shkak të veprës penale shpërlarja e parave në bashkëkryerje nga neni 302 lidhur me nenin 31 të KPRK, e lidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.6 të Ligjit në.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të dënuarve, dhe kërkesës së të dënuarit B. N. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.56/2021, të datës 14.04.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti Special, APS.nr.42/2023, të datës 31.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 26.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve B. N. dhe A. N., anulohen aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special PS.nr.56/2021, të datës 14.04..2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Departamenti Special APS.nr.42/2023, të datës 31.10.2023 dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.56/2021, të 14.04.2023, të dënuarit B. N. dhe A. N., janë shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale shpërlarja e parave nga neni 302 lidhur me nenin 31 të KPRK, e lidhur me nenin 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe 1.6 të Ligjit në.05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit dhe i ka gjykuar si në vijim: të dënuarit B. N. i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 27.05.2021 deri më

datën 26.06.2021 dhe dënim me gjobë në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) €, të cilin dënim i dënuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 1 muaji nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dënuarit A. N. i ka shqiptuar dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, dhe dënim me gjobë në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, të cilin dënim i dënuari është i obliguar ta paguaj në afat prej 1 muaji nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë ose nuk mundën ta paguajnë dënimin me gjobë, atëherë të dënuarve dënimi me gjobë iu zëvendësohet secilit veç e veç në dënim me burgim, duke i llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim nga 20 € të gjobës. Janë konfiskuar 121 bankënotat e dëmtuara, në vlerë totale prej 6050 €, si mjete të cilat janë përdorur me kryerjen e veprës penale. Janë obliguar të dënuarit B. N. dhe A. N., që në emër të dëmit të shkaktuar në mënyrë solidarë t'ia kompensojnë kërkesën pasurore juridike të dëmtuarës N. në P., në shumë prej 5.900 € në afat prej një muaji nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Janë obliguar të dënuarit që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumë prej 200 € si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej 100 €. Ndërsa në pajtim me nenin 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP, i dënuari B. N. është liruar nga akuza për veprën penale blerja, pranimi dhe fshehja e sendeve të përfituara me vepër penale nga neni 333 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK. Shpenzimet e procedurës penale bien në llogari të mjeteve buxhetore.

Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti Special, me aktgjykimin APS.nr.42/2023, të datës 31.10.2023, i ka refuzuar si të pabazuara ankesën Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës si dhe ankesat e mbrojtësve të dënuarve, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- Mbrojtësi i të dënuarit B. N., avokati Durim Osmani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vendimit lidhur me sanksionin penal, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe kërkesës pasurore juridike, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

- Mbrojtësi i të dënuarit A. N., avokati Përparim Halili, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, të shkeljes së ligjit penal, vendimit lidhur me sanksionin penal, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale dhe kërkesës pasurore juridike, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

I dënuari B. N., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të aprovohet kërkesa si e bazuar, të ndryshohen aktgjykimet e kundërshtuara

ashtu që i dënuari të lirohet nga akuza apo aktgjykimet të anulohen dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Zyra e Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.417/2023 e 09.01.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve, të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesat janë të bazuara.

I dënuari B. N., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, thekson se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, për faktin se gjykatat në aktgjykimet e tyre nuk kanë paraqitur arsyet për faktet vendimtare. Asnjëra gjykatë nuk ka dhënë arsye se me cilat prova ka vërtetuar se monedhat kontestuese a ishin siguruar me veprimtari kriminale dhe a kishte i dënuari njohuri për këtë rrethanë, të cilat përbëjnë faktet vendimtare pa sqarimin e të cilave nuk mund të shpallej fajtorë i dënuari.

Mbrojtësi i të dënuarit B. N., në kërkesë pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike në këtë çështje, për faktin se sendet nëse janë të vjedhura apo rezultat i përfitimit të veprës penale duhet të vërtetohet me siguri, në rastin konkret parat e dëmtuara në lartësi prej 5.900 € nuk është vërtetuar me siguri se janë rezultat i ndonjë vepre penale, por nga të gjitha provat vetëm ngrihet mundësia se dëmtimi me reagjent kimik mund të jetë rezultat i kontaktit me substancë kimike që mund të gjendet në qeset e parave të vjedhura dhe që shpërthejnë në raste të vjedhjes.

Më tutje në kërkesën e mbrojtësit theksohet se, gjykata e shkallës së parë ka dështuar të vërtetoj elementin subjektiv, dijeninë, dashjen dhe qëllimin e të dënuarit për të kryer veprën penale të pastrimit të parave duke iu referuar dhe elaboruar dispozitën e nenit 302 të KPRK dhe nenin 56 të ligjit për parandalimin të pastrimit të parave dhe luftimit të terrorizmit. Në këtë kuptim theksohet se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të përgjithshme dhe jo të qartë ka konstatuar, në arsyetimin e aktgjykimit se i dënuari B. N. ka pasur dijeni dhe ka qenë i vetëdijshëm se parat me reagjent kimik janë të siguruar nga aktiviteti kriminal, e fakt vendimtar i kësaj vepre penale është përcaktimi se parat burojnë nga aktiviteti kriminal, e që gjykata në kundërshtim me provat materiale, në mënyrë jo të plotë ka konstatuar këtë fakt, në mënyrë arbitrare, dhe rrjedhimisht i gjithë vendimi i gjykatave të instancave më të ulëta ka rezultuar në vendimmarrje të gabuar.

Pretendohet se, arsyetimi i aktgjykimit është kontradiktor me dispozitivin e aktgjykimit dhe provat materiale që janë administruar në shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë çështje, pasi që nëse analizohen provat materiale që janë administruar përgjigja e Policisë së Kosovës dhe përgjigja e Bankës Qendrore të Kosovës e po ashtu edhe nga dëgjimi i ekspertes N. I. nuk rezulton se këto para mund të jenë rrjedh e aktivitetit kriminal. Theksohet në kërkesë se gjykatat e instancës më të ulët në asnjë rrethanë nuk kanë arritur të vërtetojnë faktin se B. N. e ka ditur paraprakisht se parat burojnë nga aktiviteti kriminal, nuk kanë arritur të vërtetojnë ekzistimin apo burimin e aktivitetit kriminal dhe nuk është vërtetuar as në mënyrë direkte e as indirekte se këto para rrjedhin nga vepra penale apo nga aktiviteti kriminal. Arsyetimi i aktgjykimit nuk i plotëson standardet e kërkuara të një vendimi të arsyetuar për shkak se nuk ka ofruar një lidhje të qartë logjike midis fakteve të konstatuara dhe dispozitave përkatëse ligjore. Nuk ka ofruar asnjë provë të qëndrueshme se veprimet e të pandehurit korrespondojnë me figurën e veprës penale të pastrimit të parave. Lidhur me konfiskimin e dobisë pasurore të përfituar me vepër penale, theksohet në kërkesë se, gjykata vendimin për konfiskimin të kartëmonedhave si mjet i kryerjes së veprës penale e ka të pabazuar, pasi që vepra penale për arsyet e lartcekura nuk është vërtetuar se është kryer.

Mbrojtësi i të dënuarit A.N., në kërkesë fillimisht i është referuar dispozitës ligjore të veprës penale të pastrimit të parave dhe në raport me këtë vepër penale konstatimi i gjykatës rreth vërtetimit-provimit të elementit volitiv duke marr për bazë deklarin e të dënuarit në polici paraqet prejjudikim të gjykatës dhe mungesë të provuarit të faktit në anën tjetër, pasi që me asnjë provë nuk është vërtetuar pretendimi i akuzës se i dënuari ka qenë në dijeni për prejardhjen e parave në kuptim të kundërligjshmërisë së tyre, andaj vendimi i gjykatës për dënimin e të dënuarit është arbitrar, njëherit i mbështetur në supozime dhe jo prova e fakte. Fakti që paratë kanë pasur një nuancë të dëmtimit nuk është kontestues dhe se dëmtimi i parave nuk ka qenë nën standardin e qarkullueshmërisë së tyre në treg. Sipas mbrojtjes nuk është vërtetuar asnjë pretendim i akuzës që i dënuari A. të ketë qenë në dijeni për prejardhjen e parave-kartëmonedhave.

Pretendohet në kërkesë se, veprimet e të dënuarit nuk korrespondojnë me terminologjinë e nenit 56 pika 1.1 mbi vërejtjet se disa përsoshkrime në aktakuzë ishin dhe mbesin të paqarta. Gjendja faktike e përsoshkruar si në aktgjykim nuk është vërtetuar me prova konkrete dhe se provat e shqyrtuara nuk i përgjigjen figurës së veprës penale të pastrimit të parave.

Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se pretendimet e lartcekura të mbrojtësve të të dënuarve: B. N. dhe A. N., janë të bazuara, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7. lidhur me nenin 369, paragrafët 4 dhe 6 të KPP-së, ndërsa këto shkelje nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat është përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, e të cilat nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë, janë

të asaj natyre, që kanë ndikuar në ligjshmërinë dhe drejtëshmërinë e këtyre aktgjykimeve, për arsyet që do të paraqiten në vijim.

Fillimisht duhet të theksuar në nenin 369 të KPP-së është përcaktuar forma dhe përmbajtja e aktgjykimit me shkrim, ku në paragrafin 4 të këtij neni është parashikuar se *“Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 364 të këtij Kodi...”*, kurse në nenin 364, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP-së është parashikuar se *“Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon: 1.1. veprën penale për të cilën shpallet fajtor, së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal”*. Në anën tjetër, duke u bazuar në nenin 369, paragrafi 6 të KPP-së, gjykatat janë të detyruara që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqesin arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është përpiluar duke u bazuar në këto dispozita ligjore, pasi që si dispozitivi, ashtu edhe arsyetimi nuk përmbajnë sqarime të duhura në lidhje me “aktivitetin kriminal”, që konsiderohet element esencial i figurës së veprës penale për të cilën të dënuarit: B. N. dhe A. N. janë shpallur fajtor.

Bazuar në nenin 56, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit (Ligji Nr.05/L-096, i datës 25.05.2016), aktiviteti kriminal është pjesë përbërëse e figurës së veprës penale, andaj edhe si e tillë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që të mjaftohet vetëm me konstatimin se paratë burojnë nga aktiviteti kriminal, pa bërë përpjekje për të caktuar më konkretisht se për cilën formë të aktivitetit kriminal është fjala.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nuk janë fare kontestuese veprimet e më pastajshme të të dënuarve: B. N. dhe A. N., mirëpo e pa përcaktuar dhe e pa arsyetuar mjaftueshëm ka mbetur çështja e aktivitetit kriminal, nga i cili pretendohet se kanë buruar paratë e caktuara.

Gjykata Supreme e Kosovës ka parasysh parimet bazë të pavarësisë në mes të veprës penale të pastrimit të parave dhe veprës të ndërlidhur penale, parime këto të gërshtetura në nenin 56, paragrafi 3 të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizimit, megjithatë bazuar në strukturën e elementeve të figurës së veprës penale nga paragrafi 1 të këtij Ligji, vlerësohet e nevojshme që të përcaktohen, sqarohen dhe arsyetohen edhe format e aktivitetit kriminal, nga i cili pretendohet se ka buruar pasuria e caktuar.

Gjykata Supreme e Kosovës e sheh të nevojshme që të sqaron se shprehja “formë e aktivitetit kriminal” që përmendet në paragrafin 1 të nenit 56 të Ligjit të lartcekur është një nocion më i

ngushtë se shprehja “formë e paligjshmërisë”, pasi që në vete ngërthen vetëm aspekte kriminale, andaj edhe mbi bazën e kësaj, nuk janë të pranueshme pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, kur konstaton se *“Nga provat e administruara, në asnjë rrethanë nuk rezulton se paratë kanë burim - prejardhje të ligjshme, për çka arrihet në përfundimin e pakontestueshëm se derivojnë nga aktiviteti kriminal”*.

Gjykata Supreme e Kosovës thekson se “jo detyrimisht mund të konstatohet se ajo çka nuk është e ligjshme është edhe çdo herë kriminale”, pasi që paligjshmëria është një nocion më i gjerë se sa nocioni i ndonjë “formë të aktivitetit kriminal” që është akceptuar në nenin 56, paragrafi 1 të Ligjit të lartcekur. Andaj, edhe në këtë drejtim, rrjedh logjikshëm përfundimi se një veprim apo mos veprim i personit mund të jetë i paligjshëm dhe të mos jetë domosdoshmërisht pjesë e ndonjë forme të aktivitetit kriminal.

Bazuar në parimin e ligjshmërisë, që konsiderohet parim bazë i së drejtës penale, personi mund të dënohet vetëm për ato veprime apo mos veprime të cilat si të tilla kanë qenë të parashikuar në mënyrë shprehimore me ligj si vepra penale (neni 2, paragrafi 1 i KPRK).

Gjithashtu, në lidhje me këtë çështje, është e rëndësishme që të citohet neni 33, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në të cilën është parashikuar se *“Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë vepër e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si vepër penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit”*.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se kur bëhet fjalë për veprën penale të pastrimit të parave, legjislacioni jonë penal, tani për tani, e ka akceptuar formatin e “formës së aktivitetit kriminal”, andaj edhe si e tillë duhet të zbatohen në praktikën tonë gjyqësore, që dallohet nga formati i “formës së aktivitetit të paligjshëm”.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson lartë rëndësinë që kanë instrumentet e ndryshme ndërkombëtare dhe jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mirëpo bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore dhe kushtetuese, personi mund të dënohet vetëm për ato veprime apo mos veprime, të cilat në momentin e kryerjes, kanë qenë të përcaktuara më ligj si vepra penale (me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit), andaj edhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të jenë arsye për keqësimin e pozitës juridike të të pandehurit, duke sajuar vepra penale të caktuara që nuk parashihen me ligj si të tilla. Në këtë mënyrë, edhe për arsyet e cekura më lart, pikëpamjet dhe arsyetimet e gjykatës së shkallës së dytë që ndërlidhem me “aktivitetin kriminal” janë të papranueshme, pasi që nuk gjejnë mbështetje në shkresa të lëndës dhe në dispozita përkatëse ligjore dhe kushtetuese.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale me të cilat janë përfshirë aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë të asaj natyre që nuk kanë mundur që të evitohen nga Gjykata Supreme e Kosovës, kështu që të njëjtat kanë qenë arsye që kanë imponuar që detyrimisht kjo çështje penale të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Në rigjykim, gjykata e shkallës së parë duhet që ta caktoj edhe një herë shqyrtimin gjyqësor dhe t'i evitoj të gjitha shkeljet e lartcekura, ku pas administrimit të serishëm të të gjitha provave, duhet të marrë një vendim të drejtë, të ligjshëm dhe të arsyetuar mjaftueshëm për çdo pikë të aktgjykimit, ashtu siç është parashikuar me dispozitat përkatëse ligjore.

Nga arsyet që janë theksuar më lart dhe në bazë të nenit 438, paragrafi 1., nën-paragrafi 1.2. të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.704/2023, më datë 26.02.2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi